

Tema: Kryeministri Berisha merr pjese ne Inagurimin e fillimit te punimeve ne Kalaten Lindore në Portine Durrësit, si dhe Inspektimi për ndërtimin e Terminalit të Pasagjerëve.

Kryeministri Berisha inaguroi dje pasdite fillimin e punimeve në kalatën lindore në Portin e Durrësit si dhe Inspektoi punimet për Ndërtimin e Terminalit të Pasagjerëve në Portin e Durrësit. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin ministra, deputetë, përfaqësues të pushtetit lokal, drejtues dhe punonjës të portit, etj.

Z. Sali Berisha u shpreh se “ky investim, do të rrisë në mënyrë të ndjeshme kapacitetet shkarkuese, përpunuese të portit dhe kjo është një dëshmi tjetër madhore e gjallërisë dhe entuziazmit të ekonomisë shqiptare”.

Investitori për këto punime është Autoriteti Portual Durrës, me Fondin Limit prej 1,594,291,413 lek (pa TVSH). Tenderi i zhvilluar nga A.P.D-ja nxorri fitues bashkimin e operatorëve: **CMR Cooperativa Muratori Riuniti Soc.Coop a.r.l dhe Siac sh.p.k** Me vlerën e ofertuar prej **1,129,015,140 lek (pa TVSH)** për të cilën është lidhur dhe kontrata e punimeve.

Qëllimi i këtij Investimi është Rikonstruksioni i Kalatës nr.10 - 270ml (deri më sot pothuajse jashtë kushteve të punës); Zgjerimi i kalatës në 30m dhe rritja e aftësisë mbajtëse në 6 ton/m², krijimi i kushteve të mira të punës; Arritja e thellësisë së buzës së kalatës në -11,5m; Rehabilitimi i sheshit pas kalatës me gjerësi 30m ose sipërfaqje 8100 m² dhe rritja e aftësisë mbajtëse në 10ton/m².

Projektues i këtij projekti është TECHNITAL, Verona, Itali dorëzuar më 27.12.2004, nga Paolo Liberati Drejtuesi i projektit, Koordinator i projektit Francesco Cottini. Mbikqyrës i punimeve është **DIËI Consult International Albania**, me drejtues ligjor Ing. Brian KANE dhe drejtues teknik Ing. Edmond Radovicka, kontraktuar nga Autoriteti Portual.

Më pas, Kryeministri i Shqipërisë inspektoi punimet për ndërtimin e terminalit të pasagjerëve, në Portin e Durrësit, investim me vlerë rreth 40 milion euro, i cili pritet të përfundojë nga fundi i këtij viti dhe do të mirëpresë mbi 1 milion pasagjerë.

Pasi u takua dhe bisedoi me punonjësit e firmës që kryente punimet për këtë terminal, kryeministri Berisha u shpreh për mediat e pranishme: “Ky është një investim i madh prej 40 milion euro, i cili do të përfundojë nga fundi i këtij viti dhe do të mirëpresë, mbi 1 milion pasagjerë. Ka arkitekturën e terminaleve më modern që ndërtohen sot. Gjithçka bëhet për të lehtësuar në maksimum dhe në kushte sa më komode, lëvizjen e qytetarëve shqiptarë dhe të huaj, për në Shqipëri dhe e kundërta, për në vendet e tjera. Siç e shihni Porti në një afat të shkurtër nuk njihet më. Bëhet një port krejt tjetër krejt tjetër, me një terminal modern, me një kalatë e cila shtyhet në det dhe bën të mundur shkarkimin e anijeve të mëdha në 30 mijë ton dhe më të mëdha ndoshta. Investimet këtu po vazhdojnë në të gjitha drejtimet...”



SHQIPERIA
PO NDRYSHON

Shqipëria

po ndryshon!





